

## Vendim nr. 95 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (Sh) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **SHKËLQIM XHABRAHIMI**, përfaqësuar nga avokate Alba Kila, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit 00-2021-953, datë 19.05.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 17, 18, 33, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit O.Xh., i cili ka qenë trashëgimtar i vetëm ligjor i subjektit të shpronësuar H.Xh.(H.). Trashëgimtarët e këtij të fundit i janë drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (ZRKKP), qarku Tiranë me kërkesë për njohjen dhe kthimin e dy pronave të ndodhura në fshatin Sauk, komuna Farkë, Tiranë, me sipërfaqe 60 dhe 150 dynym.

2. Në përfundim të hetimit administrativ, me vendimin nr. 61, datë 28.03.2008, ZRKKP-ja, qarku Tiranë ka vendosur të mos njohë të drejtën e pronësisë së subjektit të shpronësuar H.Xh. mbi pronat me sipërfaqe 60 dhe 150 dynymë, të ndodhura në fshatin Sauk, komuna Farkë, me pretendimin se nuk është vërtetuar pronësia e subjektit të shpronësuar mbi këto pasuri. Sipas këtij organi, kërkesa është mbështetur vetëm në dy vendime gjyqësore për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë dhe trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar nuk disponojnë dhe nuk kanë paraqitur dokumentacionin e duhur hipotekor shkresor të vjetër të pronësisë, me të cilin të vërtetohet e drejta e pronësisë para datës 29.12.1944, duke mos gëzuar në këtë mënyrë cilësinë ligjore të subjektit të shpronësuar referuar ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës. Mbi bazën e ankimit të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 659, datë 24.08.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ZRKKP-së, qarku Tiranë.

3. Duke mos qenë dakord me këto vendime, trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar H.Xh. i janë drejtuar me padi gjykatës. Në përfundim të gjyqimit, me vendimin nr. 740, datë 08.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë si të pabazuar në ligj dhe prova. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 789, datë 12.04.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja është kthyer për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

4. Në rigjykim, me vendimin nr. 8813, datë 01.10.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë si të pabazuar në ligj dhe prova, duke vlerësuar se vendimet e kundërshtuara janë mbështetur në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*) dhe se dokumentacioni i paraqitur nga paditësit nuk përbën provë të mjaftueshme të burimit të origjinës së pronësisë, për rrjedhojë organi administrativ nuk mund të procedonte në njohjen e pronësisë e më pas me kthimin e saj. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim paditësit.

5. Me vendimin nr. 3759, datë 13.11.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar se kjo e fundit ka konkluduar drejt se provat e paraqitura nuk provojnë faktin juridik të pronësisë së subjektit të shpronësuar H.Xh. para vitit 1944. Kundër këtij vendimi paditësit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin nr. 00-2021-953, datë 19.05.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas atij kolegji, nga analiza e të gjithë dokumentacionit është vlerësuar dhe arsyetuar se paditësit nuk disponojnë dokumentin kryesor për vërtetimin e pretendimit, atë të origjinës së pronës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Po sipas Kolegjit Civil, gjykata e apelit ka bërë analizë të argumentuar të provave të paraqitura nga pala paditëse, si dhe ka kryer hetim gjyqësor më të zgjeruar, duke vlerësuar prova të tjera, nisur nga pretendimet e ngritura nga pala paditëse. Kolegji Civil ka vlerësuar se provat që përmenden në rekurs mbeten në kuadrin e pretendimeve dhe kërkimeve të kufitarëve dhe, po ashtu, nuk qëndron as pretendimi i paditësve se gjykatat kanë keqinterpretuar dhe keqzbatuar ligjin, pasi ato kanë argumentuar se paditësit, me provat e paraqitura në gjykim, nuk kanë arritur të provojnë se kanë plotësuar kërkesat ligjore dhe se vendimet gjyqësore të vërtetimit të faktit juridik, të vetme, nuk mund të shërbejnë si provë për kthimin e pronës.

7. Në datën 04.03.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar *e drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

8.1. *Së drejtës për shqyrtim efektiv të rekursit në mënyrë të pavarur*, pasi referuar shkaqeve të ngritura në rekurs Kolegji Civil duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore. Rekursi është paraqitur në datën 04.12.2014, kohë në të cilën ish-in në fuqi dispozitat e pandryshuara të KPC-së.

- 8.2. *Së drejtës për t`u njoftuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar palët në lidhje me procesin e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, ditën dhe orën e gjykimit. Në arsyetimin e vendimit nuk tregohet se çfarë ka ndryshuar dhe argumentet pse kjo çështje është e tillë që të gjykohet në dhomën e këshillimit.
- 8.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në rekurs është pretenduar zbatimi i gabuar i ligjit material, atij nr. 9235/2004, ndaj bazuar në këto shkaqe shqyrtimi i rekursit duhej të zhvillohej në seancë gjyqësore, në prani të palëve për t`u mundësuar atyre debatin gjyqësor dhe parashtrimin e argumenteve ligjore. Po kështu, në kushtet kur dy prej paditësve kanë ndërruar jetë, shqyrtimi në seancë gjyqësore do t`u jepte mundësinë paditësve të parashtronin këtë fakt që lidhet me palët dhe efektet e vendimit gjyqësor.
- 8.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, për shkak se vendimi i KKKP-së, bazuar në jurisprudencën kushtetuese dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), është barazuar me një vendim gjyqësor që krijon pritshmëri të ligjshme tek individit që ose do të vihet në posedim të pronës, ose do të dëmshpërblehet.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në

këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, në cilësinë e palës paditëse, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mban datën 19.05.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 04.03.2024. Sipas kërkuesit, vendimi i Kolegjit Civil nuk i është komunikuar asnjëherë zyrtarisht dhe ai është vënë në dijeni në datën 20.02.2024, kur i është komunikuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ku ndodhej shënimi se Kolegji Civil ka disponuar me mospranimin e rekursit. Sipas kërkuesit, kjo datë, referuar qëndrimit të GJEDNJ-së në çështjen Supergrav kundër Shqipërisë, konsiderohet si momenti i marrjes dijeni për vendimin.

14. Kolegji, mbi bazën e informacionit të datës 24.04.2024 të Gjykatës së Lartë, konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 26.01.2024, datë në të cilën është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë datë si ajo në të cilën kërkuesi është njohur efektivisht me vendimin, kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kriter që verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për shqyrtim efektiv të rekursit në mënyrë të pavarur, pasi referuar shkaqeve të ngritura në rekurs Kolegji Civil duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore. Sipas tij, rekursi është paraqitur në datën 04.12.2014, kohë në të cilën ishin në fuqi dispozitat e pandryshuara të KPC-së. Po në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi në rekurs është pretenduar zbatimi i gabuar i ligjit material, atij nr. 9235/2004, ndaj shqyrtimi i tij duhej të bëhej në seancë gjyqësore, në prani të palëve, për t`u mundësuar atyre debatin gjyqësor dhe parashtrimin e argumenteve ligjore. Sipas tij, në kushtet kur dy prej paditësve kanë ndërruar jetë, shqyrtimi në seancë gjyqësore do t`u jepte mundësinë paditësve të parashtronin këtë fakt që lidhet me palët dhe efektet e vendimit gjyqësor.

16. Kolegji vëren se në rastin konkret, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, nuk jemi përpara dispozitave procedurale që rregullojnë formën e gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore, e cila mund të zhvillohet, sipas parashikimeve të reja procedurale, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh ose me pjesëmarrjen e palëve. Kolegji Civil ka marrë në shqyrtim, në kuptim të nenit 472 të KPC-së (para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017), shkaqet e parashtruara në rekursin me të cilin është vënë në lëvizje, për rrjedhojë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale të nenit 480 të KPC-së, sipas të cilave mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit, pra pa praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga kjo dispozitë. Edhe Gjykata, në lidhje me mospjesëmarrjen e palëve gjatë kësaj faze të shqyrtimit të rekursit, ka vlerësuar se kjo nuk përbën proces të parregullt ligjor, pasi ky rregull i sanksionuar në dispozitat procedurale nisët nga fakti se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është seleksionues dhe i kufizuar në raste nga ligji, kështu që s`ka të bëjë

me shqyrtimin gjyqësor të çështjes (*shih vendimin nr. 65, datë 04.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kurse për sa i përket shqyrtimit të rekursit në këtë fazë të shqyrtimit, Gjykata ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit në dhomën e këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe nëse krijon bindjen se ato objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 22, datë 06.06.2011; nr. 18, datë 18.05.2011; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, kërkuesi, edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, nuk ka arritur të provojë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit.

18. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar palët në lidhje me procesin e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, ditën dhe orën e gjykimit. Në lidhje me këtë pretendim, nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se në përputhje me parashikimet e dispozitave procedurale në fuqi, në datën 04.05.2021 është shpallur lista e shqyrtimit të çështjeve në dhomën e këshillimit të datës 19.05.2021, ku bën pjesë edhe çështja e kërkuesit. Për rrjedhojë, edhe në lidhje me këtë pretendim kërkuesi nuk ka provuar në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që ai është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, ndaj ka pasur jo vetëm mundësinë për të parashtruar të gjitha pretendimet e tij kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta, por edhe detyrimin për të ndjekur ecurinë e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

19. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, për shkak se vendimi i KKKP-së, bazuar në jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së, barazohet me një vendim gjyqësor që krijon pritshmëri të ligjshme tek individit që ose do të vihet në posedim të pronës, ose do të dëmshpërblehet, Kolegji vlerëson se ai, në thelb, ka të bëjë me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme, të cilat, për nga natyra e tyre, nuk hyjnë në

juridiksionin kushtetues për sa kohë nuk janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese. Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme, pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet për kundërshtimin e vendimeve të organeve administrative që kanë rrëzuar kërkesën për njohjen dhe kthimin e dy pronave të ndodhura në fshatin Sauk, komuna Farkë, Tiranë, me sipërfaqe 60 dhe 150 dynym, u kanë dhënë atij përgjigje të arsyetuar palës paditëse, se provat e paraqitura nuk provojnë faktin juridik të pronësisë së subjektit të shpronësuar. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

20. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.